

Qerdhja/shkolla informon prindërit

Zgjeba

Në qerdhën/shkollën tonë është lajmëruar zgjeba (scabies). Për ta parandaluar përhapjen e zgjebës ju lutemi ta lexoni me kujdes këtë informim dhe sipas nevojës të veproni sipas udhëzimeve për trajtim/kurim.

Nëse te të afërmit e juaj në qerdhe apo në shkollë është lajmëruar/konstatuar zgjeba dhe nëse simptomet në familje i ngjajnë kësaj sëmundje atëherë mund të fillohet me kurim pa shkuar fare te mjeku. Sidoqoftë, shiqo përjashtimet nga ky princip në pikën "Kurë shkohet te mjeku?".

Udhëzimet për pacientin me zgjebë

Zgjebën e shkakton pleshti i zgjebës me gjatësi 0,4 mm. Pleshti femër i zgjebës gropon një korridor nën lëkurë, të gjatë 2-15 mm, në të cilin i lëshon vezët. Zhvillimi nga veja deri në plesht të ritur të zgjebës të aftë për shumim zgjatë afër 2 javë.

Zgjeba ngjitet në kontakt të lëkurës. Posaqërisht në ngrohtësi të shtratit pleshtat e zgjebës kalojnë nga njeriu në njeri. Ngjijtja p.sh. përmes çarçafave të shtretërve është shumë e rrallë. Por fëmijët mund të ia ngjeshin sëmundjen njeri tjetrit gjat lojës.

Kurë numri i pleshtave të zgjebës ritet mjaft atëherë lajmërohen simptomet të cilat shkaktojnë ndieshmëri pleshtave të zgjebës dhe tajimeve të tyre. Zgjeba ngjitet edhe para lajmërimit të simptomeve. Zakonisht, simptom i parë është kruarja e fuçishme natën që fillon 3-6 javë nga ngjijtja e sëmundjes. Shenja të grithjeve nga kruarja lajmërohen mes gishtave, nëpër duar, gjoks dhe në pjesët intime të trupit. Lëkura e irituar shpesh vjen nga infektimi. Duke i kontrolluar pjesët e irituara të lëkurës më mirë vërehen fshikëza/ushla të vogla. Koridoret janë të gjatë 2-15 mm dhe me gjërësi 0,5 mm. Ato shihen më së miri në lëkurë mes gishtave, në organet seksuale të meshkujve si dhe te fëmijët e vegjël në shuplaka dhe shputat e këmbëve. Ndonjherë është mjaft vështirë të konstatohet.

Vet-kurimi

- Peshqirat, çarçafët dhe robat/veshjet tjera duhet të lahen së paku 20 minuta në ujë të valë.
- Veshjet që nuk qëndrojnë largje me ujë mund të ruhen/futen 2 javë nëpër qese të plastikës.
- Acari dhe nxehtësia shkatrojnë me efikasitet pleshtat e zgjebës.

Për kurimin e zgjebës përdoret krema që përbën permetrin me të cilën lyhet tërë lëkura e trupit pos kokës. Lëkura duhet të lahet pas 8-15 orëve. Nëse duart lahen në ndërkohë atëherë ato duhet të lyhen prap. Duhet ikur ndjersitjes. Trajtimi/kurimi përsëritet pas 1-2 javësh, por për kontakte pa simptome mjafton një trajtim.

Ata nën moshën 2 vjeçare dhe të moshuarit (pleq) mund të trajtohen vetëm me udhëzime të mjekut. Krema me permetrin nuk guxon të përdoret gjatë shtatzanisë. Si efekt i padëshirueshëm anësor mund të paraqitet iritim dhe kruarje e lëkurës. Për qetësimin e lëkurës së irituar mund të vazhdohet me trajtim me kremë që përbën hidrokortizon dhe klorheksidin pas trjtimit me kremën që përbën permetrin.

Kurë shkohet te mjeku?

Nëse:

- Simptomet i ka fëmiu i vogël apo i moshuari
- Ka arsye të dyshohet edhe në infektim në bazë të bakterjeve
- Simptomet janë të fuçishme
- Vet-kurimi dhe vet-trajtimi me ilaçe nuk kanë efekt

Burimi: Udhëzimi i barnatorës për vet-kurim (www.itsehoito-opas.net) Shifra e artikullit: pot00156 (000.336).

Përpiloi: el/mjeke në specializim Leila Mikkilä 14.11.2008
Kontrolloi dhe verifikoi: kryemjeke Päivi Hirso 17.11.2008